UDHËZIM
Nr. 5, datë 30.5.2014

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 23.6.2008 "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT, PEZULLIMIT DHE HEQJES SË LEJEVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË DHE LEJEVE TË OPERIMIT NË FUSHAT E TRANSPORTIT DETAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 9 dhe 401, pika "b", të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 15.5.2013, "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009",

UDHËZOJ:

Ndryshimin e udhëzimit nr. 10, datë 23.6.2008, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë dhe lejeve të operimit në fushat e transportit detar", të ndryshuar, si më poshtë:

1. Në nenin 10 "Kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbeturinave të ngurta dhe vajore në zonën portuale të Durrësit dhe në radën përkatëse", në pikat 3 dhe 4, pas fjalës "…e pronësisë" të shtohen fjalët "ose kontratën e qiramarrjes…".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto